

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS– Departamenti për krime të rënda, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Mejreme Memaj, kryetare, Driton Muharremi dhe Afrim Shala, anëtare, me bashkëpunëtorin profesional Eroll Gashi, si procesmbajtës, në çështjen penale kundër të akuzuarit B.Sh. nga Peja, për shkak të veprës penale Blerje, posedim, shpërndarje dhe shitje e paautorizuar e narkotikëve të rrezikshëm dhe substancave psiko-trope dhe analoge nga neni 275 par.1 të KPRK, duke vendosur përkitazi me ankesën e mbrojtësit të akuzuarit B.Sh., të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Pejë PKR.nr.87/2008 datë 12.03.2018, në seancën e kolegjit të mbajtur me 11.05.2018 mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. Aprovohet ankesa e mbrojtësit të akuzuarit B.Sh., ndryshohet aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Pejë, PKR.nr.87/2008 datë 12.03.2018, ashtu që ndaj të akuzuarit B.Sh., për shkak të veprës penale Blerje, posedim, shpërndarje dhe shitje e paautorizuar e narkotikëve të rrezikshëm dhe substancave psiko-trope dhe analoge nga neni 275 par.1 të KPRK refuzohet akuza konform dispozitës së nenit 363 par.1 nënpar.1.3 të Kodit të Procedurës Penale (KPP), lidhur me nenin 90 par.1 pika 1.5 e lidhur me nenin 91 par.6 të Kodit Penal të Kosovës (KPK), për shkak të parashkrimit absolut të ndjekjes penale.

II. Shpenzimet e procedurës penale bien në barrën e mjeteve buxhetore të gjykatës.

A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Pejë, PKR.nr.87/2008 datë 12.03.2018, i akuzuari B.Sh., është shpallur fajtor për shkak të veprës penale Blerje, posedim, shpërndarje dhe shitje e paautorizuar e narkotikëve të rrezikshëm dhe substancave psiko-trope dhe analoge nga neni 275 par.1 të KPRK, për çka e ka gjykuar me dënim burgimi në kohëzgjatje prej 1 (një) vit me kusht që i njëjti të mos ekzekutohet nëse i akuzuari në afatin prej 1 (një) viti nuk kryen veprë të re penale dhe me dënim me gjobë në shumë prej 50 euro. Konform nenit 62 të KPK i është shqiptuar dënimi plotësues- konfiskimi i substancës narkotike marihuan në peshë prej 0.1 gram. E ka obliguar ti paguaj shpenzimet e procedurës në shumë prej 50 eurove dhe paushallin në shumë prej 25 euro dhe taksa shtesë prej 50 euro gjithsej 125 euro.

Kundër këtij aktgjykimi ankesë ka paraqitur:

- mbrojtësi i të akuzuarit B.Sh. av. Xh.K., për shkak të gjitha bazave ankimore pasi kemi parashkrim absolut dhe vendimit mbi dënim, me propozim që kjo gjykatë të konkretizoj dispozitat ligjore sa i përket parashkrimit absolut.

Prokuroria e Apelit me parashtresën PPA/I.nr.158/2018 datë 16.04.2018, ka propozuar që ankesa e mbrojtësit të akuzuarit B.Sh. të aprovohet si e bazuar pasi ka arritur vjetërsimi i veprës penale. .

Gjykata e Apelit e Kosovës pasi që shqyrtojë të gjitha shkresat e kësaj çështje juridiko-penale, studiojë aktgjykimin e kundërshtuar në kuptim të dispozitës së nenit 394 të KPP gjeti se:

- Ankesa është e bazuar.

Duke e shqyrtuar aktgjykimin e shkallës së parë në pjesën për të cilën është ushtruar ankesë, dhe sipas detyrës zyrtare konform dispozitës së nenit 394 të KPP, përkritazi me shkeljen e ligjit penal Gjykata e apelit vlerëson se me aktgjykimin e kundërshtuar është shkelur e ligji penal në anën e të akuzuarit ngase në rastin ndjekja penale është parashkruar respektivisht ka arritur parashkrimi absolut i ndjekjes penale.

Kështu, nga aktgjykimi i kundërshtuar del se i akuzuari B.Sh. është shpallë fajtor për veprën penale Blerje, posedim, shpërndarje dhe shitje e paautorizuar e narkotikëve të rrezikshëm dhe substancave psiko-trope dhe analoge nga neni 275 par.1 të KPRK, për të cilën parashihet dënimi me gjobë dhe me burgim deri në 3 vjet, kurse vepra penale rezulton të jenë kryer në mes datës 08.01.2008. Sipas dispozitës së nenit 90 par. 1 pika 5 të KPK i cili ishte i zbatueshëm në kohën e kryerjes së veprës penale ndërsa neni 106 par.1 pika 1.5 të KPRK që ka qenë gjatë zbatimit të procedurës penale në shkallë të parë, për veprat penale të dënueshme deri në 3 vite burgim ndjekja penale nuk mund të ndërmerret nëse kanë kaluar 3 vjet nga kryerja e veprës penale, ndërsa sipas dispozitës së nenit 91 par. 6 të KPK, (107 par.8 të KPRK) ndjekja penale ndalohet me çdo rast kur të ketë kaluar dyfishi i kohës së afatit të parashkrimit (ndalesa absolute mbi ndjekjen penale).

Duke pas parasysh se afati i parashkrimit fillon nga dita kur është kryer vepra penale, rezulton se që nga koha kur pretendohet se është kryer vepra penale (08.01.2008) e deri në mbajtjen e seancës së kolegjit të kësaj Gjykate gjegjësisht edhe gjatë kohës së shqyrtimit kryesor në gjykatën e shkallës së parë, kanë kaluar mbi 10 vite, çka do të thotë se në rastin konkret ndaj të akuzuarit për veprën penale për të cilën është shpallur fajtor ka arritur parashkrimi absolut i ndjekës penale dhe atë ky parashkrim ka ekzistuar edhe në kohën kur është mbajtur shqyrtimi gjyqësor në gjykatën e shkallës së parë.

Meqë, në rastin konkret ka kaluar dyfishi i kohës që kërkohet sipas ligjit për parashkrim, aktgjykimi i kundërshtuar u dashtë të ndryshohet sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi, për ç 'arsye ankesa e mbrojtësit të akuzuarit B.Sh. është jo lëndore, kurse shpenzimet e procedurës penale konform dispozitës së 454 par.1 të Kodit të Procedurës Penale bien në barrë të mjeteve buxhetore.

Nga sa u tha më lartë e konform dispozitës së nenit 403 të KPPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
PAKR.nr.164/2018, me 11.05.2018

Procesmbajtësja,
Eroll Gashi

Kryetarja e kolegjit,
1. Mejreme Memaj

Anëtarët e kolegjit:

2.Driton Muharremi

3. Afrim Shala